



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Kamëz, më 30.06.2026

PROCES - VERBAL – Tipi i kontratës-MALL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje shtylla metalike dhe krahë metalike”

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) : 31532800-2 ; 31681410-0 ; 34928510-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,675,100 *(tetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind) lekë pa tvsh.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz**, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme mbështetën në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2023, 2024, 2025**) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros për të paktën (një) nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. *Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara përparaqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* (i ndryshuar).

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin **2026** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, **Ndermarrja e Sherbimeve Publike Kamëz**, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 1.1.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se **20%** e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

dhe/ose

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Neni 55 pika 4/b. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe

bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për **artikujt 1-6** objekt prokurimi. Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë produktet e përzgjedhura, si dhe cilit katalog apo cilit prodhues i përket. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo specifikimi teknik të kërkuar në DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. *Katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuar.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ky kriter ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/ distributori zyrtar për **artikujt 1-6** objekt të prokurimit. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht dhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standartet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtëpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Deklaratë/Çertifikatë Konformiteti CE ose raportet e testimit të lëshuara nga ente certifikues të akredituar, për **artikujt 1-6** objekt prokurimi, për të cilat janë kërkuar standarte teknike të miratuara, sipas specifikimeve teknike të pasqyruara në dokumentet standarte të tenderit, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së standarteve teknike të kërkuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ky kriter ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetëdeklarimeve se duhet të ketë në pronësi ose me qira mjetet e domosdoshme për realizimin e kontratës (transportin e materialeve), si më poshtë, vijon:

<i>Mjeti transportit</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamionçinë me masë maksimale të autorizuar sipas lejes së qarkullimit 3.5 ton për transportin e materialeve objekt prokurimi	1 (një) copë	Në pronësi ose me qira

- **Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqiten:**

- 1- Leje qarkullimi e vlefshme
- 2- Cerifikatën e kontrollit teknik të vlefshme
- 3- Policë sigurimi e vlefshme
- 4- Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme
- 5- Certifikatë për leje transporti të lëshuar nga Bashkia

- **Për mjete me qera:**

- 1- Duhet të paraqitet kontrata noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti kontratës dhe afati i saj
- 2- Certifikatën e kontrollit teknik të vlefshme
- 3- Policë sigurimi e vlefshme
- 4- Mjeti të shoqërohet me fotografi të dukshme
- 5- Certifikatë për leje transporti të lëshuar nga Bashkia për të tretë ose me qera.

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t'u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve dhe grafikut të punimeve pra verteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

- Çertifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** ose ekuivalente (Standard për Sistemin e Menaxhimit të mjedisit), e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

- Çertifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo çertifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë të çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi ndërkombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoriteti kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedure që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demostrojë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorve pra AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmisimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së.

- **ISO 9001:2015 "ose ekuivalente"** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
- **ISO 14001:2015 "ose ekuivalente"** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.7 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostra për **artikujt 1-6** pranë autoritetit kontraktor, ditën dhe orën e hapjes së ofertave.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër "emri i artikullit", datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik.

Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 40, pika 2, të VKM NR. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementëve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standart të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/e saj".

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Refërime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "*ose ekuivalente*".

Data e hapjes dhe zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë më datë **13.07.2026** ora **10:00**, vendi: mënyrë elektronike në www.app.gov.al.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi është mbështetur te grupi i punës i ngritur për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të veçanta teknike, të procedurës në referencë.

NJËSIA E PROKURIMIT